



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1119/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Milena Djerić e Rafet Haxhaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.F. nga fshati ... komuna e Suharekës, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij av.S.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.310/18, të datës 31.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.310/18, i datës 31.01.2020, në pikën I të tij dhe çështja tani gjykohet si në vijim:

DETYROHET e paditura e Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 27.09.2017, të ndodhur në Suharekë, në rrugën “Hajdin Berisha”, t’ia paguaj paditësit F.F. nga fshati ... komuna e Suharekës, shumat si në vijim:

- në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 1100 euro;
- në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 800 euro;
- në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej 100 euro;
- në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 100 euro; si dhe
- në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 135 euro, që të gjitha me kamatë të gjykuar në lartësi sikurse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka për tu llogaritur nga dita marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve, nën kërcënim të përmbarimit.

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit F.F. nga fshati ... komuna e Suharekës, nga shumat e aprovuara si më lartë, e deri te shumat e kërkuara, për bazat e cekura si më lartë, si dhe

pjesa e kërkespadi së për dëmin material në emër të dëmtimit të sendeve personale (veshmbathjeve), **refuzohet si e pabazuar**.

II. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, ashtu që pika II e aktgjykimit të ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.310/18, të datës 31.01.2020, **VËRTETOHET**.

III. Pika III e aktgjykimit në fjalë të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë C.nr.310/18, të datës 31.01.2020 (që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkespadi së së paditësit), mbetet e **pashqyrtuar**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar e ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit F.F. nga fshati ... komuna e Suharekës, si të bazuar, ashtu që e ka detyruar të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë, që paditësit në fjalë në emër të dëmit jo material dhe material t’ia paguaj shumat si në vijim: për dëmin jo material, gjithsej 3000 euro dhe atë në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 2100 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 900 euro, kurse për dëmin material shumën prej 685 euro. Me pikën II të aktgjykimit është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1075 euro, ku të gjitha shumat si në pikën I dhe II të aktgjykimit, duhet t’i paguaj brenda afatit prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit, me kamatë 8%. Me pikën III të aktgjykimit është refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadi së së paditësit, respektivisht dallimi mbi shumën e aprovuar si në pikën një dhe dy të të dispozitivit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e saj të aprovohet si e bazuar, të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, apo që aktgjykimi në fjalë të ndryshohet dhe të gjykohet në shumën e ofruar nga e paditura.

Në bazë të shkresave të lëndës konstatohet se paditësi nuk ka parashtruar ankesë, e as përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurës, është pjesërisht e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit të tij, me datën 06.06.2018, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.310/18, të datës 31.01.2020, me të cilin pjesërisht e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, sikurse në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se në rastin konkret kërkespadia e paditësit ka qenë pjesërisht e bazuar, sepse nga provat e administruara dhe faktet tjera jokontestuese, është provuar se me datën 27.09.2017 në Suharekë, në rrugën "Hajdin Berisha, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, të cilin e ka shkatuar Sh. (Sh.) Q. nga fshati Duhël komuna e Suharekës, i cili ditën e aksidentit kishte sigurim të vlefshëm tek e paditura. Në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, fakt ky i provuar përmes provave të administruara e sidomos ekspertizës së ekspertit të ortopedisë dr.RR.SH., si dhe asaj të ekspertit të psikiatrisë dr.N.F., të datës 18.12.2019, të cilave gjykata e shkallës së parë ua ka falur besimin e plotë. Baza juridike e kërkespadisë në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese. Për bazë ligjore, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136, 159, 169.2 dhe 183 të Ligjit mbi Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD), në lidhje me nenin 14 të LPK. Për kamatën gjykata në fjalë ka vendosur në pajtim me nenin 382 të LMD, kurse në raport me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform neneve 452.5, 454.1 dhe 453.2 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK dhe se drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar edhe gjendjen faktike në këtë procedurë, por gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjykuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësit në emër të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara fizike dhe frikën, kurse për dëmin material në emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj si dhe për ushqimin e përforcuar, për paditësin, për çka u deshtë që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të vendoset si në pikën I të këtij aktgjykimi të gjykatës së shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishtme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, pastaj rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit dhe rrjedhimisht përfundimin për vëllimin e kërkesës së aprovuar.

Gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qendrojnë pretendimet ankimore të të paditurës as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të

aktgjykimit të ankimuar. Sipas gjykatës së shkallës së dytë gjendja faktike në këtë procedurë është vëretuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket aspektit të shkaktarit të aksidentit, si dhe pasojave që ka pësuar paditësi për shkak të aksidentit në fjalë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së ekspertit të ortopedisë dr.RR.SH., të datës 18.12.2019, si dhe ekspertizën e ekspertit të psikiatrisë dr.N.F., të datës 18.12.2019, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm. U tha edhe më lartë se baza juridike në këtë çështje nuk ka qenë kontestuese. Mbi bazën e të lartëcekurave del se nuk qendrojnë pretendimet e të paditurës për vërtetimin jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike në këtë procedurë.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës për aplikimin e gabuar të drejtës materiale në emër të dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara fizike dhe për frikën e pësuar të paditësit, kurse për dëmin material në emër të ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj, si dhe për ushqimin e përforcuar, nga arsyeja se shumata e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë të larta, nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit, si dhe nuk janë gjykuar në pajtim me shkallën e përgjegjësisë së të paditurës për shkatimin e aksidentit të datës 27.09.2017, në të cilën paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupore, prandaj në këtë drejtim gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditurës, e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë në pikën I të tij dhe gjykoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se shumata e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e lartcekura të kompensimit, nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as në natyrën dhe llojin e të mirës së dëmtuar në këtë rast.

Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e gjykuara si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 par.2 të LMD të zbatuar për këtë rast dhe se këto shuma përfaqësojnë një satisfaksion adekuat që i dëmtuari (në këtë rast paditësi) t'i përballoj më lehtë dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 183 par.2 të LMD përcaktohet se *“me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit dhe me dhimbjet fizike të pësuar, ashtu që ky kompensim të përfaqësoj një lehtësim në përballimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, e në të njëjtën kohë ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Shumata e kërkuara përtej shumave të aprovuara për bazat e cekura si më lartë, si dhe pjesën e kërkespadiisë për dëmin material në emër të dëmtimit të sendeve personale (veshmbathjeve), gjykata e shkallës së dytë i refuzoj si të pabazuara, ngase gjeti se të njëjtat nuk përkojnë me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, as me shkallën e

përgjegjësisë së të paditurës në këtë rast, e as me natyrën dhe shkallën e të mirës së privuar të paditësit si pasojë e aksidentit komunikacionit në fjalë, në ndërkohë që për dëmtimin e sendeve personale (veshmbajthjeve), paditësi nuk ia ka dorëzuar gjykatës së shkallës së parë asnjë provë konkrete. Për këtë arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Edhe në raport me kamatën e gjykuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në pajtim me nenin 382 të LPK. Për këtë arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi duke gjetur se gjykata e shkallës së parë në raport me shpenzimet e procedurës ka marrë vendim të drejtë, i cili vendim është nxjerr në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në pajtim me tarifën përkatëse të OAK, si dhe në pajtim me dispozitat e LPK.

Gjykata e Apelit ka vendosur sikurse në pikën III të këtij aktgjykimi, pasi që në raport me pikën III të aktgjykimit të ankimuar, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të palës ankuese, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), në lidhje me nenin 201 pika (d) të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1119/2020, me datën 15.07.2021

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj